



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 215/6 prot.

Datë 07.03.2024

V E N D I M
Nr. 251/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.03.2024, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-87736-11-15-2023, me objekt “Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projekt - ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara”, me fond limit 50,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK me NIPT (L72023002P) & “DAAM” SHPK me NIPT (L72205042F), me adresë: Rruga “Haxhi Dalliu”, Hyrja 1, Apartamenti 0, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Shkodër, me adresë: Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.11.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-87736-11-15-2023, me objekt “Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projekt

- ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara”, me fond limit 50,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datë 18.12.2023, referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton, se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (*shprehja e interesit*), nga verifikimi i së cilës rezulton, se kanë shprehur interes operatorët ekonomikë si më poshtë cituar:

1. BOE “Casanova + Hernandez architects Dega Shqiptare” DSHH & “Atelier 4” SHPK
2. “Gjeokonsult & CO” SHPK
3. “A & E Engineering” SHPK
4. BOE “Enginering Consulting Group” SHPK & “A V E Consulting” SHPK & “Rezart Joniadhi” PF
5. BOE “HUK - Projekt” SHPK & “Infra – Plan” SHPK & “24PV” SHPK
6. BOE “NET - Group” SHPK & “DAAM” SHPK
7. BOE “Studio - Rebus” SHPK & “Archispace” SHPK
8. BOE “Tower” SHPK & “Taulant” SHPK & “Archnet 360” SHPK
9. BOE “UTS-01” SHPK & “PNI-2001” SHPK
10. BOE “Zenit & CO” SHPK & “Grama” SHPK & “Arkimade” SHPK
11. BOE “Instituti Dekliada – Alb” SHPK & “Arena MK” SHPK

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe verifikimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, rezulton, se në datën 11.01.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën (*short-listing*), duke njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. BOE “Casanova + Hernandez architects Dega Shqiptare” DSHH & “Atelier 4” SHPK
kualifikuar
2. “Gjeokonsult & CO” SHPK
kualifikuar
3. “A & E Engineering” SHPK
skualifikuar
4. BOE “Enginering Consulting Group” SHPK & “A V E Consulting” SHPK & “Rezart Joniadhi” PF
skualifikuar
5. BOE “HUK - Projekt” SHPK & “Infra – Plan” SHPK & “24PV” SHPK
skualifikuar
6. BOE “NET - Group” SHPK & “DAAM” SHPK
kualifikuar
7. BOE “Studio - Rebus” SHPK & “Archispace” SHPK
skualifikuar
8. BOE “Tower” SHPK & “Taulant” SHPK & “Archnet 360” SHPK
kualifikuar
9. BOE “UTS-01” SHPK & “PNI-2001” SHPK
skualifikuar
10. BOE “Zenit & CO” SHPK & “Grama” SHPK & “Arkimade” SHPK
kualifikuar
11. BOE “Instituti Dekliada – Alb” SHPK & “Arena MK” SHPK
skualifikuar

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton, se në datën 11.01.2024, autoriteti kontraktor nëpërmjet rubrikës “Kërkesa”, ka njoftuar operatorët ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë, për dorëzimin e dokumentacionit provues dhe justifikues në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe verifikimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, rezulton, se në datën 24.01.2024, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës dhe ka zhvilluar fazën (*short-listing*) si më poshtë:

1. BOE “Casanova + Hernandez architects Dega Shqiptare” DSHH & “Atelier 4” SHPK
kualifikuar
2. “Gjeokonsult & CO” SHPK
kualifikuar
3. “A & E Engineering” SHPK
skualifikuar
4. BOE “Enginerring Consulting Group” SHPK & “A V E Consulting” SHPK & “Rezart Joniadhi” PF
skualifikuar
5. BOE “HUK - Projekt” SHPK & “Infra – Plan” SHPK & “24PV” SHPK
skualifikuar
6. BOE “NET - Group” SHPK & “DAAM” SHPK
skualifikuar
7. BOE “Studio - Rebus” SHPK & “Archispace” SHPK
skualifikuar
8. BOE “Tower” SHPK & “Taulant” SHPK & “Archnet 360” SHPK
skualifikuar
9. BOE “UTS-01” SHPK & “PNI-2001” SHPK
skualifikuar
10. BOE “Zenit & CO” SHPK & “Grama” SHPK & “Arkimade” SHPK
skualifikuar
11. BOE “Instituti Dekliada – Alb” SHPK & “Arena MK” SHPK
skualifikuar

II.6. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “NET - Group” SHPK & “DAAM” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyetimin si më poshtë:

1. - Oferta juaj skualifikohet bazuar ne Ligjin Nr. 162/2020”Për prokurimin publik”, pika 2 dhe pika 3, Vendimit nr.113, date 1.3.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pasi drejtuesit teknik te shoqerise Net Group sh.p.k., D.Mitrushi , L.Kuci , B.Demneri, E.Spahiu dhe L. Falaska referuar listepageses se muajit te fundit nuk jane paguar me dite te plote pune, ne kundershjim te plote me kontratat individuale te punes ku figurojne me kohe te plote dhe te deklarates ne formularin permbledhes te vetdeklarimit piken D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.

- Oferta juaj skualifikohet bazuar ne Ligjin Nr. 162/2020”Për prokurimin publik”, pika 2 dhe pika 3, Vendimit nr.113, date 1.3.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, pasi drejtuesit teknik te shoqerise DAAM sh.p.k., A.Bani dhe F.Dalipi, referuar listepageses se muajit te fundit nuk jane paguar me dite te plote pune ne kundershjim te plote me kontratat individuale te punes ku figurojne me kohe te plote dhe te deklarates ne formularin permbledhes te vetdeklarimit piken D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.”

II.7. Në datën 30.01.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokollit 215 prot., datë 30.01.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “NET - Group” SHPK & “DAAM” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 215/2 prot., datë 31.01.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 215 protokollit, datë 30.01.2024.

II.9. Me anë të shkresës Nr.253/1 prot., datë 07.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 215/3 prot., datë 09.02.2024, me objekt “Informacion”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK pranë autoritetit kontraktor.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se: “[...] Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se numri i ekspertëve që BOE Net-Group shpk & DAAM shpk ka angazhuar në këtë procedurë është mbi kërkesat minimale të tenderit dhe mund të mbulojë lehtësisht kërkesat e një projekti të tillë pavarësisht nga numri i ditëve të angazhimit të Drejtuesve Teknikë në listëpagesën e Nëntorit. Përveç kësaj, theksojmë se Drejtuesit Teknik janë të punësuar me kontratë me kohë të plotë siç parashikohet në legjislacionin për Punësimin dhe atë për Drejtuesit Teknik (bazuar Vendim Nr. 943, datë 28.12.2016, Kodi i Punës i RSH, Vendim

nr.113, datë 1.3.2023) dhe pjesa më e madhe e tyre janë të angazhuar me kohë të plotë për menaxhimin e anës teknike të projekteve. Për sa i përket atyre që në listëpagesë nuk shfaqen me të ditë të plota pune, ju bëjmë me dije se angazhimi i tyre varet jo vetëm nga numri i projekteve që kryejnë kompanitë e këtij BOE apo angazhimi aktual që i nevojitet kompanive të BOE, por edhe nga raste të problemeve shëndetësore apo personale. Për këto arsye ata mund të mos shfaqen në çdo muaj me ditë të plota në listëpagesa. Por kjo nuk do të thotë që angazhimi i tyre nuk do të shtohet në momentin që Kompanitë fitojnë projekte të reja. [...] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:

- 1(nje) Urbanist;
- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi/1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Ekspert Mjedisi

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- **Një projektues/inxhinier nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit(deklarate nga projektuesi).**
- **Stafi i angazhuar (projektues/inxhinier) duhet të paraqesë një deklaratë të disponueshmërisë për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë**

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë, datë 14.12.2023, ndërmjet operatorit ekonomik “Net - Group” SHPK dhe operatorit ekonomik “DAAM” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku në pikën 4 “Pjesëmarrja”

përcaktohet: “Pjesëmarrja e anëtarëve të grupit e shprehur në fusha/ekspertiza për arritjen e objekteve të kësaj kontrate, do të jetë siç vijon:

- Shoqëria “Net - Group” SHPK 70 %
- Shoqëria “DAAM” SHPK 30 %

[...]

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, i plotësuar, nga operatori ekonomik “Net-Group” SHPK, ku ndër të tjera ka deklaruar:
 - o Znj. D.Mitrushi – Arkitekt
 - o Z. A. Dushi – Arkitekt, Restaurator i Monumenteve të Kulturës
 - o Z. I. Kokalari – Inxhinier Ndërtimi
 - o Znj. L. Kuci – Inxhinier Hidroteknik
 - o Z. B.Demneri – Inxhinier Elektrik
 - o Z. E.Spahiu – Ekspert Mjedisi, Inxhinier Ndërtimi
 - o Z. L.Falasca – Inxhinier Ndërtimi
 - o Z. V.Begaj – Ekspert Privat Zjarrfikës, Inxhinier Gjeolog, Inxhinier Mjedisi, Ekspert Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë, Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave, Auditues Energjistik në Ndërtësa dhe Instalime Industriale, Menaxher Energjie;
- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, i plotësuar, nga operatori ekonomik “DAAM” SHPK;
 - o Z. S. Ngjelina – Urbanist
 - o Znj. Kamela Sali – Arkitekt
 - o Znj. A.Bani – Inxhinier Ndërtimi
 - o Z. Fatjon Dalipi - Inxhinier Elektrik, Auditues Energjistik në Ndërtësa
 - o Znj. A. Lama – Inxhinier Ndërtimi
 - o Z. E.Lami – Inxhinier Elektrik, Ekspert Privat Zjarrfikës, Ekspert Përgjegjës për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë, Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave, Menaxher Energjie;
 - o Z. T. Spahiu – Inxhinier Hidroteknik, Ekspert Mjedisi
- Licencë N.6945/7, në emër të shoqërisë “DAAM”, “Në Projektim”, lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Licencë N.6830/14, në emër të shoqërisë “NET - Group”, “Në Projektim”, lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

III.1.3. Në nenin 43 “Procedurë e kufizuar”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Procedura e kufizuar është procedurë me dy faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi, i cili përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

2. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi. Në rastin e kontratave sektoriale, kur entet kontraktore kanë shpallur një njoftim periodik të informacionit, që është përdorur si mjet për të bërë ftesën për konkurrim, ky afat është jo më pak se 15 ditë.

3. Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet në këtë ligj.

Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për pranimin e ofertave është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.

Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t'u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është të paktën 10 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.

4. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, kur autoritetet kontraktore kanë shpallur një njoftim paraprak të informacionit, që nuk është përdorur si mjet për të bërë ftesën për pjesëmarrje, afati kohor minimal për pranimin e ofertave apo kërkesave për pjesëmarrje, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, bëhet 10 ditë nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) njoftimi paraprak i informacionit përfshin të gjithë informacionin që kërkohet sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, në rast se ai informacion është i disponueshëm në momentin kur shpallet njoftimi paraprak i informacionit;

b) njoftimi paraprak i informacionit është shpallur nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës së shpalljes të njoftimit të kontratës.

5. Për procedurat e kufizuara ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, afatet kohore minimale të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë:

a) për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, afati kohor është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës;

b) për pranimin e ofertave, afati kohor është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e ftesës për ofertë.

Në procedurat e kufizuara ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afatet kohore minimale të përcaktuara nga enti kontraktor janë:

i. për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, afati kohor është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës.

ii. afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t'u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre.

Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është jo më pak se 10 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.

6. Autoriteti kontraktor mund të shkurtojë me 5 ditë afatin kohor për marrjen e ofertave në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike.

Në rast se dokumentet e tenderit nuk janë të disponueshme nëpërmjet mjeteve elektronike, sipas parashikimeve të nenit 17 të këtij ligji, afati për dorëzimin e ofertave zgjatet me 5 ditë.

III.1.4. Në nenin 58 “Ftesa për ofertë”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet:

1. Në procedurat e prokurimit me faza, autoriteti ose enti kontraktor fton nëpërmjet një komunikimi me mjete elektronike ose me shkrim njëherësh të gjithë kandidatët e përzgjedhur për të vazhduar në fazën e dytë, për të dorëzuar ofertat ose për të negociuar e dialoguar.

2. Përmbajtja e ftesës për ofertë përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

III.1.8. Në Vendimin Nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, në “Rregullore për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, në nenin 21, nenin 22 dhe nenin 23, përcaktohet:

“Neni 21

1. Çdo individ apo shoqëri, vendas ose i huaj për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë Komisionit të posaçëm të dhënies së licencave profesionale për t'u pajisur me licencë profesionale, pasi të ketë plotësuar kushtet që përcaktohen në këtë rregullore.

2. Kushtet dhe kriteret specifike të cilat kërkohen në përgjithësi për të fituar kategoritë e veprimtarisë në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim, jepen në vijim të kësaj rregulloreje dhe në lidhjet nr. 4 dhe nr. 5 të rregullores.

Neni 22

Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale, janë:

1. Për studim e projektim.

- Të jetë diplomuar në nivelin master profesional apo shkencor në arsimin e lartë përkatës, pranë institucioneve të arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi apo të ketë njehsuar diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

- Të ketë vite eksperience në projektim, mbi 2 vjet në institucione publike projektuese, shoqëri studimi e projektimi, ose institucionet e arsimit të lartë.

2. Për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim

- Të jetë diplomuar në nivelin master profesional apo shkencor në arsimin e lartë përkatës, pranë institucioneve të arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi apo të ketë njehsuar diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

- Të ketë mbi 15 vjet eksperiencë në studime e projekte apo zbatimin në ndërtim, në profesionin përkatës;

- Të mos jetë drejtues teknik ose i punësuar në Shoqëri për zbatimin në ndërtim. Kushtet e mësipërme paraprake, vlejné dhe për individët e huaj që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale.

Neni 23

Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale e drejtuesit teknik të shoqërisë, janë:

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë për studime e projekte, është një ose më shumë individë të pajisur me licencë profesionale individuale dhe me vite eksperiencë jo më pak se 5 vjet. Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin, rezulton 9 ose më shumë, mund të regjistrohet drejtues teknik dhe me 3 vite eksperiencë. Individu mund të përfitojë licencën individuale njëkohësisht me vendosjen si drejtues teknik.

2. Drejtuesi Teknik i Shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim, është një ose më shumë individë të pajisur me licencë profesionale individuale në fushën respektive dhe me vite eksperiencë jo më pak se 15 vjet. Individu mund të përfitojë licencën individuale njëkohësisht me vendosjen si drejtues teknik.

3. Shoqëria fiton licencë profesionale mbështetur dhe në përputhje me licencën profesionale individuale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ajo ka, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar me këtë cilësi në dy a më shumë Shoqëri.

5. Drejtuesi/drejtuesit teknikë duhet të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë për një periudhë jo më pak se një vit.

6. Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me Shoqërinë rregullohen me Kodin e Punës dhe Kontratë punësimi.

Në rastet e shoqërive të huaja që kërkojnë të përfitojnë licencë profesionale, zbatohen të njëjtat kushte dhe kriteret paraprake si më sipër.

- Kur drejtuesi teknik i shoqërisë së përbashkët ose të huaj është vendas, zbatohen të njëjtat kushte paraprake si për drejtuesin teknik të shoqërisë.

- Kur drejtuesi teknik i shoqërisë së huaj ose të përbashkët, është i huaj, bëhet ekuivalentimi I licencës individuale të tij sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe gjithashtu zbatohen të njëjtat kushte paraprake si për shoqëritë vendase.”

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Sa më sipër, nisur nga lloji i kësaj procedurë prokurimi “*Procedurë e hapur e kufizuar*”, referuar nenit 43 pika 1 të LPP-së, procedura e kufizuar është procedurë me dy faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi, i cili përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji.

Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se më datë 18.12.2023, është zhvilluar faza e shprehjes së interesit, më pas në datë 11.01.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e “short – listing”, ku rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues është kualifikuar për këtë fazë. Nga verifikimi në SPE rezulton, se po në datën 11.01.2024, autoriteti kontraktor nëpërmjet rubrikës “Kërkesa” në SPE, ka njoftuar operatorët ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë për paraqitjen e dokumentacionit shkresor dhe justifikues origjinal ose të noterizuar.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit pas verifikimit të dokumentacionit provues të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatorët ekonomikë të kualifikuar, ka kryer procesin e rivlerësimit të ofertave bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe në datë 24.01.2024 është zhvilluar “short – listing” në SPE, ku bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net-Group” SHPK & “DAAM” SHPK rezulton i skualifikuar.

III.1.11. Në rastin konkret, nisur nga arsyet e skualifikimit, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të

mësipërm, për drejtuesit teknik, secili nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilët në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor i pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta.

Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net-Group” SHPK & “DAAM” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentin *Kontratë për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë*, datë 14.12.2023, ndërmjet operatorit ekonomik “Net - Group” SHPK dhe operatorit ekonomik “DAAM” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku në pikën 4 “Pjesëmarrja” përcaktohet: *“Pjesëmarrja e anëtarëve të grupit e shprehur në fusha/ekspertiza për arritjen e objekteve të kësaj kontrate, do të jetë siç vijon:*

- | | |
|-------------------------------|------|
| - Shoqëria “Net - Group” SHPK | 70 % |
| - Shoqëria “DAAM” SHPK | 30 % |

[...].

Akoma më tej, referuar ndarjes së shërbimeve që do të kryejë secili prej anëtarëve, të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, bashkëlidhur marrëveshjes së bashkëpunimit rezulton, se të gjitha shërbimet do realizohen 70 % nga operatori ekonomik “Net - Group” SHPK dhe 30 % nga operatori ekonomik “DAAM” SHPK, për këtë arsye, secili prej operatorëve ekonomikë, anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomikë, duhet të përmbushë kriterin në lidhje me drejtuesit teknik, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në këtë bashkim, në përputhje me parashikimet e përcaktuara në nenin 88 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar.

Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë, ka dorëzuar në SPE Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 7, të plotësuar nga secili prej tyre, ku rezulton se në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, kanë deklaruar stafin që disponojnë.

Konkretisht në pikën 2.3.3 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar që: *“Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:*

- 1 (nje) Urbanist;
- 1 (nje) Arkitekt;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi/1 (nje) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Ekspert Mjedisi

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë .

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast, AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatoret ekonomike të kualifikuara të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- *Një projektues/inxhinier nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit(deklarate nga projektuesi).*
- *Stafi i angazhuar (projektues/inxhinier) duhet të paraqesë një deklaratë të disponueshmërisë për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë..*

Nisur nga arsyeja e skualifikimit se “...drejtuesit teknik të shoqërisë Net Group sh.p.k., D.Mitrushi, L.Kuci, B.Demneri, E.Spahiu dhe L. Falaska referuar listëpagesës së muajit të fundit nuk janë paguar me ditë të plota pune në kundërshtim të plotë me kontratat individuale të punës ku figurojnë me kohë të plotë dhe të deklaratës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit piken D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës. [...]drejtuesit teknik të shoqërisë DAAM sh.p.k., A.Bani dhe F.Dalipi, referuar listëpagesës së muajit të fundit nuk janë paguar me ditë të plota pune në kundërshtim të plotë me kontratat individuale të punës ku figurojnë me kohë të plote dhe të deklaratës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit piken D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën nr. 2531 prot., datë 07.02.2024, protokolluar me tonën me nr.215/3 prot., datë 09.02.2024, konstatohet, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK, në përmbushje të kriterit për Drejtuesit teknik, referuar deklaratimeve të tij në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për secilin prej tyre ka paraqitur si më poshtë:

-Kontratë pune, Nr. Rep 2400, Nr. Kol 710, datë 05.08.2022 midis shoqërisë “Net - Group” SHPK si Punëdhënës dhe z.E.S si punëmarrës, me detyrë “*Inxhinier Ndërtimi dhe Ekspert i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Drejtues Teknik*”.

- Kontratë pune, Nr. Rep 1434, Nr. Kol 343, datë 23.02.2021 midis shoqërisë “Net - Group” SHPK si Punëdhënës dhe z.L.F si punëmarrës, me detyrë “*Inxhinier Ndërtimi, profili Planifikim Territori dhe Mbrojtje të Dherash*”.

- Kontratë pune, Nr. Rep 2405, Nr. Kol 715, datë 05.08.2022 midis shoqërisë “Net - Group” SHPK si Punëdhënës dhe z.B.D si punëmarrës, me detyrë “*Inxhinier Elektrik, Drejtues Teknik*”.

- Kontratë pune, datë 05.08.2022 midis shoqërisë “Net - Group” SHPK si Punëdhënës dhe z.L.K si punëmarrës, me detyrë “*Inxhinier Hidroteknik, Drejtues Teknik*”.

- Kontratë pune, Nr. Rep 2401, Nr. Kol 711, datë 05.08.2022 midis shoqërisë “Net - Group” SHPK si Punëdhënës dhe znj.D.M si punëmarrës, me detyrë “*Arkitekt, Drejtues Teknik*”.

- Listëpagesat e shoqërisë “Net – Group” SHPK për muajt Gusht – Shtator – Tetor 2023.

-Kontratë pune, Nr. Rep 2005, Nr. Kol 606, datë 29.06.2022 midis shoqërisë “DAAM” SHPK si Punëdhënës dhe znj.A.B si punëmarrës, me detyrë “*Inxhinier Ndërtimi, Drejtues Teknik*”.

-Kontratë pune, Nr. Rep 7210, Nr. Kol 1973, datë 16.09.2019 midis shoqërisë “DAAM” SHPK si Punëdhënës dhe z.F.D si punëmarrës, me detyrë “Drejtues Teknik”.

- Listëpagesat e shoqërisë “DAAM” SHPK për muajt Gusht – Shtator – Tetor 2023.

III.1.12. Në Vendimin Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, në “Rregullore për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, në nenin 21, përcaktohet se: **Çdo individ apo shoqëri, vendas ose i huaj për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë Komisionit të posaçëm të dhënies së licencave profesionale për t’u pajisur me licencë profesionale, pasi të ketë plotësuar kushtet që përcaktohen në këtë rregullore.**

Ndërsa në nenin 23 pika 1, 3, 4, 5, 6 të “Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, përcaktohet se: Kushtet paraprake për licencë profesionale individuale e drejtuesit teknik të shoqërisë, janë:

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë për studime e projekte, është një ose më shumë individë të pajisur me licencë profesionale individuale dhe me vite eksperiencë jo më pak se 5 vjet. Në rastin kur mesatarja e notave të shkollës së lartë për individin, rezulton 9 ose më shumë, mund të regjistrohet drejtues teknik dhe me 3 vite eksperiencë. Individu mund të përfitojë licencën individuale njëkohësisht me vendosjen si drejtues teknik.

3. Shoqëria fiton licencë profesionale mbështetur dhe në përputhje me licencën profesionale individuale të drejtuesit/drejtuesve teknikë që ajo ka, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të Komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

4. **Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar me këtë cilësi në dy a më shumë Shoqëri.**

5. Drejtuesi/drejtuesit teknikë duhet të jenë në marrëdhënie pune me shoqërinë për një periudhë jo më pak se një vit.

6. **Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me Shoqërinë rregullohen me Kodin e Punës dhe Kontratë punësimi.**

[...]

III.1.13. Sa më sipër, nisur nga arsyet e skualifikimit, pretendimet e ankimuesit, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga ky i fundit në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, për drejtuesit teknik, konstatohet, se për drejtuesit teknik të shoqërisë “Net – Group” SHPK (D.Mitrushi , L.Kuci, B.Demneri , E.Spahiu dhe L. Falaska), si dhe drejtuesit teknik të shoqërisë “DAAM” SHPK (A.Bani dhe F.Dalipi), për secilin prej tyre bashkimi i operatorëve ekonomikë ka dorëzuar Kontrata Individuale të Punës, ku specifikohet se “Kohëzgjatja normale ditore e punës nuk do të jetë më shumë se 8 orë. Kohëzgjatja normale javore e punës është jo më shumë se 40 orë. Numri maksimal i orëve të punës gjatë javës nuk mund të kalojë 48 orë.” Ndërkohë nga verifikimi i listëpagesave për muajin e fundit të paguar deri në datën e zhvillimit të procedurës, për muajin Tetor 2023 rezulton, se për drejtuesit teknik të shoqërisë

“Net – Group” SHPK (znj. D.Mitrushi është paguar për 7 ditë kalendarike të punuara gjatë muajit; z. L.Kuci është paguar për 7 ditë kalendarike të punuara gjatë muajit; z. B.Demneri është paguar për 8 ditë kalendarike të punuara gjatë muajit; z. E.Spahiu është paguar për 7 ditë kalendarike të punuara gjatë muajit; z. L. Falaska është paguar për 2 ditë kalendarike të punuara gjatë muajit). Ndërsa punonjësit drejtues teknik të shoqërisë “DAAM” SHPK për muajin Tetor, referuar listepagesave të shoqërisë, rezulton se janë paguar respektivisht znj. A.Bani për 10 ditë kalendarike të punuara gjatë muajit dhe z.F.Dalipi për 6 ditë kalendarike të punuara gjatë muajit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 23 pika 6 të Vendimit Nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*”, përcaktohet që “**Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen me Kodin e Punës dhe Kontratë Punësimi**”.

Sa më sipër, referuar kontratës së punës të secilit prej drejtuesve teknike të mësipërm, rezulton se janë të punësuar me kohë të plotë pranë shoqërive përkatëse “Net – Group” SHPK dhe “DAAM” SHPK, por nga verifikimi i listepagesave nuk figurojnë se këta punonjës janë paguar për kohë të plotë sipas kushteve të kontratës. Vlen të theksojmë, se vërtet në kriterin e kualifikimit për drejtuesit teknik kërkohet që “*të jenë të përfshirë në listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar*”, por gjithashtu vihet re, se edhe për muajt paraardhës këta punonjës janë paguar për ditë kalendarike më pak se periudha e caktuar në kontratën e punës, duke mos dëshmuar kështu se drejtuesit teknik janë në shërbim të këtyre shoqërive sipas kushteve të përcaktuara në Vendimin Nr. 759, datë 12.11.2014, si dhe sipas kontratës së punës ndërmjet tyre dhe shoqërive përkatëse.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se në ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohen përkufizimi i kontratës së punës, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit, afati, paga etj. Në nenin 12 përcaktohet, se “*Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë në punë dhe shpërblimin e punëmarrësit*”.

Pra, kontrata e punës është dokumenti i cili rregullon marrëdhëniet e punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke përcaktuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe kushtet e punës, si orët e punës, pagën etj.

Sa më sipër, për sa kohë referuar legjislacionit të posaçëm, konkretisht nenit 23 pika 6 të Vendimit Nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*”, përcaktohet që “**Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen me Kodin e Punës dhe Kontratë Punësimi**”, gjykojmë, se punëdhënësi duhet t’i përmbahet kushteve të Kontratës së Punës. Kështu që, për sa kohë në kontratën e punës të secilit prej drejtuesve teknikë të mësipërm, përcaktohet kryerja

e punës me kohë të plotë, rrjedhimisht punëdhënësi duhet t'i përmbahet këtyre kushteve të përcaktuara në marrëveshjen që rregullon marrëdhëniet e punës. Nga listëpagesat e të dyja shoqërive "Net – Group" SHPK dhe "DAAM" SHPK, si për muajin e fundit të deklaruar (tetor 2023) të kërkuar në kriteret e kualifikimit, por edhe në muajt paraardhës, rezulton se drejtuesit teknik të sipërcituar, janë punësuar me kohë të pjesshme dhe janë paguar për ditë të caktuara, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në kontratën e punës përkatëse.

Akoma më tej, për sa i përket argumentit të sjellë nga ankimuesi, se *"Për sa i përket atyre që në listëpagesë nuk shfaqen me të dië të plota pune, ju bëjmë me dije se angazhimi i tyre varet jo vetëm nga numri i projekteve që kryejnë kompanitë e këtij BOE apo angazhimi aktual që i nevojitet kompanivetë BOE, por edhe nga raste të problemeve shëndetësore apo personale"*, ky i fundit, si palë e interesuar në këtë procedurë prokurimit, nuk ka paraqitur asnjë fakt, provë apo argument, i cili vërteton pretendimet e tij.

Sa më sipër, gjykojmë, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, me dokumentacionin e mësipërm, nuk vërtetojnë punësimin e punonjësve (drejtues teknik), në përputhje me Vendimin Nr. 759, datë 12.11.2014 *"Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim"*, si dhe dispozitat e posaçme që rregullojnë marrëdhëniet e punës sipas ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *"Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik"*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Net - Group" SHPK & "DAAM" SHPK, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar"*, me Nr.REF-87736-11-15-2023, me objekt *"Hartimi i studimeve të fizibilitetit, planeve zhvillimore, masterplane, projekt-ide teknike dhe projekteve teknike të ndryshme të detajuara"*, me fond limit 50,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor, lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifave financiare të paguara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Net - Group” SHPK & “DAAM” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

